

KALENDARI I PËRGATITJES SË BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027

DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Brenda muajit dhjetor	Kryetari i NJVQV	Përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e NJVQV kalendarin e PBA dhe të buxhetit vjetor.
Jo më vonë se data 31 dhjetor	Këshilli i NJVQV	Shqyrton dhe miraton kalendarin e PBA dhe të buxhetit vjetor.
Brenda datës 10 janar	Kryetari i NJVQV	Shpërndan kalendarin e PBA dhe të buxhetit vjetor tek të gjitha njësitë shpenzuese të NJVQV.
Jo më vonë se data 31 janar	Kryetari i NJVQV	Paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.
Jo më vonë se data 1 mars	Këshilli i NJVQV	Miraton raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave.
Brenda datës 15 mars	Kryetari i NJVQV	Paraqet për miratim në këshillin e NJVQV tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së.
Jo më vonë se data 15 mars	Këshilli i NJVQV	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA të NJVQV dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.
Jo më vonë se 20 mars	Kryetari i NJVQV	Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të NJVQV dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.
Jo më vonë se data 20 prill	Njësitë shpenzuese	Paraqesin kërkesat brenda tavanëve përgatitore tek Njësia e Menaxhimit të Programeve dhe japin argumenta për fonde/tavane shtesë.
Brenda datës 30 maj	Kryetari i NJVQV	Përgatit dokumentin e parë të PBA.
Brenda datës 1 qershor	Kryetari i NJVQV	I dërgon Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Projekt-Dokumentin e PBA.
Brenda datës 20 qershor	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Dërgon zyrtarisht në NJVQV një raport me mendime mbi PBA.
Brenda datës 21 qershor	Kryetari i NJVQV	I dërgon këshillit të NJVQV për miratim projektin e parë të PBA së bashku me opinionin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
Brenda datës 30 qershor	Këshilli i NJVQV	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të PBA duke shprehur edhe opinionin mbi rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
Brenda datës 5 korrik	Kryetari i NJVQV	Publikon dokumentin e parë të PBA.
Brenda datës 10 korrik	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA.
Brenda datës 15 korrik	Kryetari i NJVQV	Përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e NJVQV tavanet përfundimtare.
Brenda datës 20 korrik	Këshilli i NJVQV	Miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve.
Jo më vonë se 25 korrik	Kryetari i NJVQV	Miraton udhëzimin plotësues për përgatitjen e PBA të NJVQV dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.
Brenda datës 1 gusht	Njësitë shpenzuese	Paraqesin kërkesat brenda tavanëve përfundimtare.
1-30 gusht	Kryetari i NJVQV	Fillon punën për përgatitjen e Projektit të Rishikuar të PBA.
Gjatë periudhës 1-15 shtator	Kryetari i NJVQV	Organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit.
Brenda datës 15 shtator	Kryetari i NJVQV	Dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e Rishikuar të PBA, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë.
Brenda datës 5 tetor	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Zhvillon seanca konsultimi me NJVQV.
Brenda datës 20 tetor	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Sipas rastit, dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA.
Jo më vonë se data 30 nëntor	Kryetari i NJVQV	Përgatit PBA përfundimtar dhe e paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshillin e NJVQV së bashku me projektbuxhetin vjetor.
Jo më vonë se data 25 dhjetor	Këshilli i NJVQV	Miraton PBA përfundimtar.
Jo më vonë se data 31 dhjetor	Kryetari i NJVQV	Merr masa për të publikuar dokumentin e plotë të PBA, përfshirë dokumentacionin e tyre shoqërues.